



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

VENDIM

Nr. 70, datë 29. 10. 2019

PËR

**PËRCAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE QË PËRFAQËSOJNË FSHZH NË
CILËSINË E ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË AGJENCIA EKONOMIKE
MBËSHTETËSE SH.P.K (AEM SH.P.K)**

Mbështetur në nenin 13 të ligjit nr.10130, datë 11.05.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, pikën 4 të nenit 13 të Statutit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 82, datë 17.07.2009, i ndryshuar, Drejtori Ekzekutiv me iniciativën e tij;

Duke qenë se Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në cilësinë e ortakut të vetëm, më datë 19.06.2018 ka rregjistruar në regjistrat publike shoqërinë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k, me ortak të vetëm FSHZH, me objekt veprimtarie sikurse parashikohet në Statutin e Shoqërisë;

Duke qenë se në bazë të ndryshimit të pikës 4 të Nenit 13 të Statutit të FSHZH, miratuar me Vendimin nr. 188, datë 25.07.2019 “Për miratimin e një ndryshimi në Statutin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit” të Këshillit Drejtues, është parashikuar se përfaqësimi i FSHZH-së, në cilësinë e ortakut të shoqërive tregtare, ku institucioni ka pjesëmarrje, kryhet nga Drejtori Ekzekutiv dhe nga përfaqësuesit e departamenteve dhe/ose njësive dhe se këta përfaqësues përcaktohen me vendim të Drejtorit Ekzekutiv,

Me qëllim marrjen e vendimeve të bazura dhe gjithëpërfshirëse, duke shfrytëzuar ekspertizën e çdo departamenti në trajtimin e çështjeve objekt vendimarrje nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë AEM sh.p.k,

VENDOSA:

1. Fondi Shqiptar i Zhvillimit që përfaqëson ortakun e vetëm të shoqërisë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k (AEM sh.p.k), do të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj shoqërie, me përfaqësuesit si më poshtë:

- Drejtori Ekzekutiv
- Përgjegjësi i Njesisë së Asistencës, Raportimit dhe Kontrollit
- Drejtori i Departamentit të Infrastrukturës;
- Drejtori i Departamentit të Zhvillimit Rajonal
- Drejtori i Departamentit të Financës,
- Drejtori i Departamentit Juridik dhe Prokurimeve,
- Drejtori i Departamentit të Funksioneve Mbështetëse

2. Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, ftohen rast pas rasti edhe punonjës të tjerë që referojnë për çështje të natyrës së ngushtë teknike.

3. Në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, përfaqësues të departamenteve teknike të FSHZH, fusha përkatëse e përgjegjësisë dhe ekspertiza e të cilave lidhet me çështjet objekt vendim marrje nga Asambleja e Përgjithshme, procedojnë me një prezantim të çështjeve dhe analizën e kryer.

4. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, merren në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe statutit të shoqërisë AEM sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, i njoftohet të gjithë Departamenteve dhe Njësive të Menaxhimit të Projekteve dhe depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Dritan Agolli

Drejtor Ekzekutiv





FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Nr. 1580 Prot

Tiranë, më 29 / 10 / 2019

Lënda: Kërkesë për pasqyrim të vendimit të ortakut të vetëm

Drejtuar: QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Tiranë 1010

Të nderuar zotërinj,

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është person juridik dhe gëzon statusin e organizatës jofitimprurëse nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë së tij për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social, të qendrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e vendor, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit, në zbatim të ligjit nr.10130, datë 11.5.2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar.

Në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 2, shkronja "d" të ligjit Nr. 10130, datë 11. 05. 2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar dhe të nenin 4 të Statutit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 82, datë 17.07.2009, të ndryshuar, Fondi Shqiptar i Zhvillimit krijoi me datë 01. 06. 2018 shoqërinë "Agjencia Ekonomike Mbështetëse" sh.p.k (AEM sh.p.k), me NUIS L81819025K .

Shoqëria AEM sh.p.k ushtron aktivitetin e saj sipas ligjit Nr. 9901, datë 14. 04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe krijimi i saj u pa i arsyeshëm për menaxhimin e objekteve të rijetëzuara dhe të mirmbajtura nga FSHZH, ose ushtrimin e aktiviteteve të tjera fitimprurëse, që do prodhonin të ardhura për financimin e veprimtarive të saj për zbatimin dhe realizimin e qëllimit dhe objektivave të ortakut të saj të vetëm Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të përcaktuara në Nr. 10130, datë 11. 05. 2009 "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar.

Me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 169, datë 06. 12. 2018 "Për miratimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar themeluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit" është vendosur dhënia e pëlqimit për objektin e veprimtarisë së shoqërisë AEM sh.p.k, qëllimi i veprimtarisë së të cilës do të ishte menaxhimi i aktiviteteve ekonomike në



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

fushën e shërbimeve me interes publik, turizmit, kulturës, hotelerisë, teknologjisë së informacionit, bujqësisë si dhe aktivitete të tjera ekonomike.

Misioni i shoqërisë AEM sh.p.k është të jetë një aktor aktiv për zhvillimin e veprimtarive me interes publik në mjedisin e biznesit që nepërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta financiare apo ne partneritet me sipërmarrje private vendase dhe të huaja të nxis zhvillimin ekonomik në nivel rajonal, lokal dhe qendror.

Funksionet dhe fusha e veprimtarisë ekonomike të kësaj shoqërie do të konsistojnë kryesisht në:

Investimin dhe menaxhimin e aktiviteteve ekonomike nëfushën e turizmit, kulturës, hotelerisë, shërbimeve me interes publik, IT, bujqësisë, energjisësërinovueshme, aktivitetit tregtar, import-eksport, etj.;

Projektim dhe ndërtim të objekteve të cilat tërheqin interes publik;

Kryerjen e operacione financiare apo tregtare që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, ne zbatim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

Konsulenca me objekt marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për zbatimin e projekteve të ndryshme;

Vepron si agjent ekonomik për asetet publike të transferuara tek FSHZH nga Qeveria Shqiptare;

Menaxhon dhe operon investimet e kryera nga FSHZH në marrëveshje me përfituesit/pronarët, për të siguruar funksionimin dhe qëndrueshmërinë e tyre afat gjatë në shërbim dhe për interes të publikut.

Në pikën 4, të nenit 13 të Statutit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 82, datë 17.07.2009, të ndryshuar, është parashikuar se: " Përfaqësimi i FSHZH-së, në cilësinë e ortakut, në organet drejtuese të shoqërive tregtare, ku institucioni ka pjesëmarrje, kryhet nga Drejtori Ekzekutiv dhe nga përfaqësuesit e departamenteve dhe/ose njësive. Përfaqësuesit e departamenteve dhe/ose njësive, përcaktohen me vendim të Drejtorit Ekzekutiv, në varësi të objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe të çështjeve që trajtohen për të cilat do të ketë vendimarrje."



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

Meqenëse aktiviteti i shoqërisë AEM sh.p.k është kompleks dhe vendimarrja për çështje të caktuara të parashikuara nga Neni 81 i Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" kërkon ekspertizë të posaçme, nga përfaqësues të departamenteve të FSHZH, në varësi të objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe të çështjeve që trajtohen për të cilat do të ketë vendimarrje kolegjiale, nga Drejtori Ekzekutiv është miratuar me Vendimin Nr. 70, datë 29.10.2019 "Për përcaktimin e përfaqësuesve që përfaqësojnë FSHZH në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k (AEM sh.p.k)", janë përcaktuar përfaqësuesi e Fondit Shqiptar të Zhvillimit që do të marrin vendime për aktivitetin e AEM sh.p.k.

Në vijim të sa mësipër paraqesim për të regjistruar në Regjistrin Tregtar, Vendimin Nr. 70, datë 29.10. 2019 " Për përcaktimin e përfaqësuesve që përfaqësojnë FSHZH në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k (AEM sh.p.k)".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me respekt,
Dritan AGOLLI
Drejtor Ekzekutiv



Konceptoi: Adnand Berdica
Miratoi: Gentian Këri

F.SH.ZH HYRJE

11-11-2019

Nr. 1580/1 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
DREJTORIA E KËRKIMIT DHE UDHËHEQJES
METODOLOGJIKE

Nr. 13796/1, Prot.

Tiranë, më 8.11.2019

Lënda: Kthim përgjigje

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
Adresa: Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 1580 Prot., datë 29.10.2019, protokolluar nga institucioni ynë me nr. 13796 Prot., datë 31.10.2019, me anë të së cilës është bashkëlidhur Vendimi nr. 70, datë 29.10.2019, me qëllim regjistrimin e tij pranë regjistrarit tregtar, për subjektin "Agjencia Ekonomike Mbështetëse" shpk, me NUIS L81819025K, , ju bëjmë me dije se :

Qendra Kombëtare e Biznesit, bazuar në nenin 3, të Ligjit nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", është institucioni përgjegjës për regjistrimin e subjekteve tregtare dhe të dhënave pranë regjistrarit tregtar referuar procedurës së parashikuar në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Ndërkohë, sqarojmë se bazuar në nenin 20 dhe 27, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, parashikohet se regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër në Regjistrin Tregtar bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendit të ushtrimit të veprimtarisë, vendbanimit apo selisë së aplikantit.

Mbështetur në sa më sipër, me qëllim regjistrimin e tij pranë regjistrarit tregtar, lutemi të aplikoni pranë çdo sporteli të shërbimit të QKB, në përputhje me procedurën ligjore përkatëse.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

